



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 2484 Prot.

Tiranë, më: 11 . 3 . 2019

Nr. Identifikimi 205

Vendimi 12

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Mos paisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “GPP Korça” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L73724004N

Adresa e selisë: Lagjja nr 1, Capri Center, shkalla nr. 3, Apartamenti nr. 5, Pogradec, Korçë

Personi përgjegjës: Kresimir Condic

Për të zhvilluar projektin “**Termocentrali me gaz në Korçë**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Fusha e Korcës, Bulgarec, Bashkia Korçë

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Sugjerimet të reflektohen të gjitha komentet.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujërave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Duke marrë në konsideratë zonën ku do të ushtrohet aktiviteti, një zonë me përparësi për zhvillimin e bujqësisë, gjykojmë se ky projekt shkakton ndikime të rëndësishme negative me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

Konkretisht, zhvillimi i aktivitetit, shoqërohet me:

- shkarkimin në masë të gazrave të dëmshëm NO_x, SO_x, CO²,
- shkarkime të ujërave të ndotur të linjës teknologjike

Këto emetime ndikojnë negativisht në:

- Cilësinë e tokës bujqësore
- Cilësinë e ajrit, duke e lidhur këtë edhe me orientimin e erërave të zonës drejt Bashkisë së Korcës
- Florën dhe faunën e zonës

Në raportin e thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:

- Deklarohet se impianti do të funksionojë me gaz metan, por nuk jepen detaje dhe specifikimet e teknologjisë
- Nuk është trajtuar e detajuar çështja e shkarkimeve në tërësi
- Nuk është detajuar projekti i izolimit të terrenit për ruajtjen e kontaminimit të ujërave sipërfaqësor nga aktivitetit me ujërat nëntokësor të zonës
- Nuk janë propozuar alternativa dhe masat përkatëse për minimizimin e shkarkimeve në ajër gjatë funksionimit të termocentralit
- Nuk janë marrë në konsideratë ndikimet që lidhen me ndryshimet klimatike
- Nuk janë trajtuar problematikat në lidhje me çështjen e mbrojtjes së natyrës dhe në lidhje me përfaqshen që do të ketë ky projekt kundrejt zonave të mbrojtura, në afërsi të zones ku do të

zhvillohet projekti, si dhe kundrejt zonave të cilat do të evidentohen të rëndësishme për habitatet, florën dhe faunën

- Nuk është bërë një vlerësim kumulativ për sa i përket ndikimit në mjedis dhe lidhja e projektit me zhvillimin e zones
- Dëgjesa publike nuk i është përmbajtur VKM-së Nr. 247, date: 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”. Në takim nuk kanë qënë të pranishëm banorë të zonës, ku do të ngrihet projekti dhe që preken direkt nga zhvillimi i tij
- Referuar planvendosjes sipas Raportit Teknik, ky impiant ndodhet pranë qytetit të Korcës, që është dhe qendra më e madhe e banuar dhe e zhvilluar e rajonit jug-lindor e Shqipërisë
- Për sa i përket cështjes së mbetjeve që do të gjenerohen, nuk përshkruhen alternativa dhe masat konkrete për menaxhimin e integruar të tyre, bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI

BLENDI KLOSI



